

Titulli: Informatë për programet Fulbright të hapura për aplikim për vitin akademik 2022-2023

Të dashur aplikantë,

Në emër të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Kosovë, dëshirojmë të ndajmë me ju lajmin e mrekullueshëm lidhur me programet Fulbright që tashmë janë të hapura për vitin akademik 2022-2023!

Programi Fulbright Faculty Development është i dizajnuar për stafin e ri akademik që për momentin janë të angazhuar në mësimdhënie në Kosovë. Pas përfundimit të programit, aplikantët duhet të synojnë që të kthehen në pozitat e tyre në institucionet vendase dhe të vazhdojnë me përgjegjësitë e tyre si mësimdhënës, si dhe të aplikojnë njohuritë dhe përvojën e fituar. Programi Fulbright Faculty Development është i strukturuar si grant 5 mujor, duke filluar në mes të muajit gusht për të përfunduar në mes të muajit janar. Qëllimi i programit është njohja e pjesëmarrësve me praktikat më të mira dhe qasjet teorike në zhvillimin e kurrikulumit në SHBA dhe t'u ofrohen atyre strategji konkrete për zhvillimin e kurrikulumit të lëndës, përfshirë një përmbledhje të burimeve akademike dhe hulumtuese. Gjatë programit, bursistët pritet të hulumtojnë dhe zhvillojnë një përskrim të lëndës, planprogramin dhe strategjitë specifike të mësimdhënjes për lëndën e tyre të propozuar.

Konkursi për Programin Fulbright Faculty Development për vitin 2022-2023 do të vazhdojë të jetë i hapur deri më 18 tetor, 2021. Për aplikimin online dhe udhëzimet tjera, ju lutemi të klikoni këtu: <https://apply.iie.org/ffsp2022>

Për më shumë informata: [U.S. Embassy in Kosovo](#)

Ky është program i përbashkët i Departamentit të Shtetit Amerikan dhe Qeverisë së Kosovës.

Programi Fulbright Visiting Scholar është program jo i gradës, post doktoratës, për hulumtuesit e rinjë dhe të avansuar, ligjëruesit universitarë, dhe ekspertët nga institucionet akademike dhe hulumtuese në Kosovë. Ky program sjell studiuesit në Shtetet e Bashkuara për hulumtim të avansuar për një periudhë prej tre deri në gjashtë muaj. Programi mbulon shkollimin, shpenzimet mujore të mirëmbajtjes, shpezimet për libra dhe furnizime, si dhe udhëtimin vajtje-ardhje për në institucionin nikoqir.

Konkursi për Programin Fulbright Visiting Scholar për vitin 2022-2023 do të vazhdojë të jetë i hapur deri më 1 nëntor, 2021. Për aplikimin online dhe udhëzimet tjera, ju lutemi të klikoni këtu: <https://apply.iie.org/fvsp2022/>

Për më shumë informata: [U.S. Embassy in Kosovo](#)

Ky është program i përbashkët i Departamentit të Shtetit Amerikan dhe Qeverisë së Kosovës.

The Fulbright-National Archives Heritage Science Fellowship, komponentë e Fulbright Visiting Scholar Program, ofron një mundësi për studiuesit që të lidhen me shkencëtarët dhe ekspertët e Arkivave Kombëtare gjatë kryerjes së hulumtit në laboratorin më të ri për hulumtim dhe testim shkencor të trashëgimisë pranë Arkivave Kombëtare në College Park, Maryland. Kjo bursë mundësohet nga Departamenti i Shtetit Amerikan dhe Administratës së Arkivave Kombëtare dhe të Dhënave. Bursa ishte themeluar për të mbështetur edukimin shkencor të arkivave, ruajtjen dhe hulumtimin e tyre.

Bursisti/ja i/e përzgjedhur do të punojë në Laboratorin për Testim dhe Hulumtin Shkencorë pranë Arkivave Kombëtare, në një objekt me pajisjet më të reja, përqëndruar në hulumtim shkencor me qëllim të ruajtjes, mbrojtjes dhe qasjes së vazhdueshme të publikut në artefaktet, të dhëna dhe dokumente kulturore dhe historike.

Konkursi për Bursën Fulbright-National Archives Heritage Science për vitin akademik 2022-2023 do të vazhdojë të jetë i hapur deri më 15 tetor, 2021. Për aplikimin online dhe udhëzimet tjera, ju lutemi të klikoni këtu: <https://cies.org/fulbrightnationalarchives>, dhe për të gjitha informatat tjera rreth bursës, vizitoni <https://cies.org/fulbrightnationalarchives>.

Për më shumë informata: [U.S. Embassy in Kosovo](#)

Ju faleminderit,

Ekipi i Këshillit Amerikan

Për pyetje rreth programeve, ju lutem kontaktoni Nora Nimani-Musa: nmusa@americancouncils.org